

**STATUT DHE AKT-THEMELIM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ZERO LOUNGE”**

Ky statut perpilohet nga ortakët:

Arian Cara, i biri i **_Shyqyri_** i ditelindjes **_18/06/1983_**, lindur ne Durrës, dhe banues ne Tirane. i pajisur me **_Karte ID me nr _ I30618202I**, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Bledar Shehu, i biri i **_Bashkim_** i ditelindjes **_18/05/1986_**, lindur ne Durrës, dhe banues ne Durrës. i pajisur me **_Karte ID me nr I60518084A_**, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Te quajturit me poshte ortak themelues, me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me nenin 230 pika 2 e ligjit te ligji nr.9901 date, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto çeshtje, pershtat organizimin dhe funksionimin e shoqerise duke miratuar ndryshimet ne statut si me poshte:

**KREU I
NENI 1
FORMA**

Ortakët e mesiperm riorganizojne Shoqerine sipas formes ligjore me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2
EMRI I SHOQERISE**

Emri i shoqerise do te jete **ZERO LOUNGE** **SH.P.K**



01/03/2025

NENI 3
SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Durres me adrese: **Lagja Nr.4 Rruga Egnatia Godine Banimi 8-10 Kate, Kati i Pare Z.K. 8514, Durres**
Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 4
KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

BAR – SNACK BAR.

KREU II
KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT
THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themltar shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke i ndare ne 2 kuote.

- Arian CARA I cili zoteron 1 kuote te perbere nga 1 pjese me vlere 50.000(Pesedhjet e mije) leke .
 - Bledar SHEHU I cili zoteron 1 kuote te perbere nga 1 pjese me vlere 50.000(Pesedhjet e mije) leke .
-



01/03/2025

NENI 7 KONTRIBUTET

Kontributi percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti i takojne ortakeve themelues ne masen 100%

NENI 8

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen 100%.

NENI 9

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qofte se ndodh ne rast vdekjeje.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 10

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit.



01/03/2025



NENI 11

DREJTIMI SHOQERISE

Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve mblidhet si rregull dy here ne vit, si dhe sa here qe gjykohet e aresyeshme. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

NENI 12

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve vendos per keto çeshtje:

- Emeron administratorin e shoqerise.
- Emeron ekspertet kontabel.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos per shperndarjen e dividendit te shoqerise.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.
- Si dhe per cdo ceshtje qe gjykon te aresyeshme
- Vendimet e asamblese nenshkruhen nga ortakët

NENI 13

ADMINISTRATORI

Shoqeria do te administrohet nga z. **Arian Cara**, per nje afat 5 vjecare me te drejte riprteritje.

01/03/2025



NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratoret e shoqërise emerohet nga asambleja e ortakeve të cilët përgjigjen për zbatimin e vendimeve të asamblese së ortakeve.

Administratoret e shoqërise kanë këto kompetenca:

- të paraqitet, përfaqëson dhe nënshkruan për shoqërinë,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udhëheq veprimtarinë e shoqërisë,
- të organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- përgatit pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raportet mbi veprimtarinë e shoqërise,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Asambleja,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemin e punëmarrësve në vende pune,
- kujdeset për ligjshmerinë e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Asamblese.

Administratoret e shoqërise janë të detyruar që vendimet në lidhje me kompetencat e sipërcituara të marrin vetëm bashkërisht me unanimitet.

KREUI V

LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 15

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabel që kërkon legjislacioni në fuqi edhe këto libra:

- 1- Libri i ortakeve, në të cilin shënohen emrat e plotë të Ortakeve dhe kuotat që secili ka në kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Administratoreve.
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit sindikal.

01/03/2025



NENI 16
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar mund te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta te hartuara nga admimstratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

KREU V
NENI 17
AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje te çdo viti financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe hartohet nje raport me shkrim Bilancit i bashkengjiten:

- a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria,
- b. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria,

Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne ditën qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.


NENI 18

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullmi i çdo fondi te veçante caktohet nga asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me ligjin nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".



NENI 19

PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese Ortakeve .

NENI 20

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit.

NENI 21

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete raste emertimit te shoqerise i shpohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likuidimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likuidimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

NENI 22

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emeron nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

NENI 23

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e Ortakeve .

01/03/2025



NENI 24

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve.

Mjetet fmanciare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditorët.

NENI 25

DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Pumesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit. Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.

Durres me 01/03/2025.

Ortakët e Shoqerise:

Arian Cara



Bledar Shehu

